

VENDIM
Nr.428, datë 2.7.2004

PËR MËNYRËN E TRANSFERIMIT TË PAKETËS SË AKSIONEVE TË MBETURA TË
SHOQËRISË ANONIME “ALBTELECOM”, PAS TRANSFERIMIT TË PAKETËS TEK
INVESTITORËT STRATEGJIKË, “ALBAPOST” SHA,
ISH-PRONARËT E TRUALLIT DHE PUNONJËSIT E SHOQËRISË ANONIME
“ALBTELECOM”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 9 të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë” dhe të neneve 1 e 2, pika 4 të ligjit nr.8810, datë 17.5.2001 “Për përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë anonime “Albtelecom””, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë dhe të Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Paketa e aksioneve të mbetura e shoqërisë anonime “Albtelecom”, pas transferimit të paketës tek investitorët strategjikë, “Albapost” sh.a., ish-pronarët e truallit dhe punonjësit e shoqërisë anonime “Albtelecom”, të transferohet nëpërmjet ankandit publik.

2. Ngarkohet Ministri i Ekonomisë dhe Ministri i Transportit dhe i Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano